



AIDA

ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



NEWSLETTER

JANAR - MARS 2020

Revista e AIDA-s, *newsletter*, është botim i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Vitin që shkoi AIDA doli me një publikim të vetëm *newsletter 2019*, ku u përmbledh aktiviteti i agjencisë për vitin kalendarik. Nga janari i vitit 2020 e në vazhdim revista do të publikohet periodikisht 1 herë në 3 muaj.

AIDA-s ka si qëllim që me anë të këtij botimi të informojë në mënyrë të vazhdueshme publikun dhe bizneset për aktivitetin e agjencisë.

Aktiviteti i AIDA-s për tre muajin e parë të 2020 ka përfshirë takimet me bizneset e vogla dhe të mesme, pjesëmarrjen në panaire ndërkombëtare si dhe takimet shumëpalëshe për ndërtimin e marrëdhënieve të reja nëpërmjet bashkëpunimeve rajonale si dhe tërheqjen e investimeve të huaja në vend.


Në mes të muajit mars të këtij viti Shqipëria u përball me pandeminë e shkaktuar nga virusi COVID-19. Nga ky moment, veprimtaria e institucionit ka rrjedhur me ritmin e gjithë administratës publike, që nuk ka qenë në frontin e parë në luftën ndaj virusit. Agjencia i ka vijuar punët e saj duke përdorur teknologjinë dhe *smart working* duke vënë në plan të parë shëndetin e nëpunësve të saj, familjarëve të tyre dhe të secilit qytetar.

AIDA i bën thirrje publikut të respektojë masat parandaluese në mënyrë që të mund t'i kthehemi normalitetit sa më shpejt.

Për t'u informuar mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve na vizitoni në:

 info@aida.gov.al

 aida.gov.al

 +355 (0)42 251 001


 [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)

 AIDA - Albanian Investment Development Agency

SHESHO KURBËN!

RESPEKTO MASAT PARANDALUESE



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në përshtatje me situatën e krijuar nga COVID-19, ju rikujton se ne vazhdojmë të jemi në dispozicion me shërbimet tona si më poshtë.

Në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave për përballimin e situatës së krijuar nga COVID 19, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), nga data 12.03.2020 ka marrë masat si më poshtë:

Takimet ose mbledhjet e planifikuara, nuk zhvillohen pranë ambienteve të AIDA-s, por nëpërmjet "skype call", duke shmangur kontaktin fizik;

Dorëzimi i aplikimeve ose dokumenteve për statusin e investitorit strategjik, bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare;

Dokumentet e çfarëdollojshme përcillen përmes Postës Shqiptare ose nëpërmjet adresës zyrtare të AIDA-s, info@aida.gov.al;

Aktiviteti i AIDA-s vijon normalisht. Për çdo informacion, ju lutem vizitoni faqen tonë të web-it (www.aida.gov.al) dhe rrjetet tona sociale (facebook, instagram, twitter).

AIDA Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ka në fokus promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues vendas, si edhe promovimin e potencialit turistik kombëtar.

Gjithnjë e më shumë AIDA po synon gjetjen e qasjeve të reja në funksion të përmirësimit të shërbimeve që ofron. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet objektivave konkrete të vendosura për vitin 2020 nga secila drejtori, duke ndërthurur punën e përbashkët profesionale si institucion drejt një qëllimi.

Më rendësi për punën e AIDA-s gjatë vitit 2020 është mbështetja konkrete ndaj biznesit vendas, thjeshtimi i procedurave për investitorët e huaj; vendosja e bashkëpunimeve të reja dhe të suksesshme me institucionet, në ndihmë të klimës së investimeve; përçimi i informacionit të përditësuar për investitorët e huaj dhe ata vendas; realizimi i disa "outreach campaign" në sektorët potencialë, realizimi i disa pyetësorëve për kompanitë që kanë investuar në Shqipëri për t'u njohur me nevojat e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.



invest in Albania



INFO DAY

DITËT INFORMUESE PËR BIZNESET

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), janë një nga motorët kryesorë të zhvillimit të ekonomisë shqiptare.

AIDA, në kuadër të mbështetjes dhe zhvillimit të NVM-ve shqiptare ofron disa shërbime si: asistencë teknike, ndërtim të kapaciteteve, informim mbi tregjet dhe doganat, mbështetje për promovim nëpërmjet panairëve, misionëve të biznesit, kërkimeve të tregut dhe publikimeve të përgjithshme sektoriale, krijimit të një mjedisi të favorshëm për inovacionin, si edhe informim dhe asistim për t'u bërë pjesë e skemave dhe projekteve që AIDA menaxhon.

AIDA, në kuadër të informimit të NVM-ve mbi shërbimet që ofron, organizon gjatë vitit disa ditë informimi për bizneset e mesme dhe të vogla shqiptare.

Info Day e parë për vitin 2020 u zhvillua në qytetin e Gjirokastrës. Në kalendarin e institucionit janë parashikuar edhe disa data të tjera për ditë informimi pranë bizneseve shqiptare dhe së shpejti do të zhvillohen edhe në qytetet e tjera, duke i ardhur në ndihmë bizneseve me informacionet e nevojshme.

AIDA, me një aktivitet “Info Day” për bizneset në qarkun Gjirokastrër

AIDA në kuadër të informimit të bizneseve vendase, zhvilloi në muajin janar, në qytetin e Gjirokastrës një ditë informuese me bizneset e këtij qarku.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja e bizneseve të qarkut Gjirokastrër me misionin e agjencisë dhe përkrahjen që AIDA ofron për bizneset shqiptare. Në takim u vu theksi në mbështetjen e biznesit me qëllim lehtësimin e shërbimeve, adresimin e problematikave të hasura, mbështetjes për pjesëmarrje në panaire dhe asistimin e kompanive për t'u bërë pjesë e skemave të granteve që AIDA menaxhon.

Cjatë takimit, përfaqësuesit e bizneseve pjesëmarrëse ngritën çështje dhe problematika konkrete, ku u diskutua mbi promovimin e produkteve “Made in Albania”.





NEWSLETTER

Janar - Mars 2020

RRITEN EKSPORTET ME 5.2% NË MUAJIN JANAR 2020

Eksportet e mallrave të Shqipërisë rriten me 5.2% sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga INSTAT. Eksportet arritën vlerën 23 miliardë lekë në muajin janar 2020, duke u rritur me 5,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 4,9 %, në krahasim me dhjetor 2019.

Kategoria më e madhe e mallrave të eksportuara nga Shqipëria gjatë muajit të parë të vitit 2020 ishin mineralet, karburantet dhe energjia elektrike, materialet e ndërtimit, metalet dhe makineritë.

Bashkimi Europian (BE), përbënte 73.1% të totalit të mallrave të eksportuara nga Shqipëria gjatë muajit janar.





BASHKËPUNIME TË AIDA-S

Nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare dhe Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara

Në muajin shkurt 2020, AIDA nënshkroi memorandumin e bashkëpunimit midis Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare dhe Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, për bashkërendimin e punës për shtimin e shërbimeve pranë Dhomës së Biznesit të Diasporës. Kjo mbështetje do të shtrihet në ofrimin e asistencës dhe konsulencës së nevojshme nga AIDA ndaj investitorëve të diasporës, me të gjitha informacionet e rëndësishme rreth mundësive të investimit në Shqipëri.

AIDA ka shprehur disponueshmërinë ndaj Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, me vendosjen e një punonjësi të AIDA-s brenda zyrave të saj, për të asistuar komunikimin e vazhdueshëm midis tyre, si dhe për të ndihmuar respektivisht njëra tjetrën në fushat e interesit të përbashkët.



AIDA mirëpret Agjencinë e Investimeve të Huaja dhe Promovimit të Eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s Z. Sokol Nano, priti në një takim në muajin shkurt 2020, Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Investimeve të Huaja dhe Promovimit të Eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut Z. Arben Vila. Në këtë takim, përfaqësuesit prezantuan fokusin dhe misionin e institucioneve respektive, duke u ndalur në strategjinë për tërheqjen e investimeve të huaja dhe reformat qeveritare që e mbështesin këtë. Gjatë takimit, u diskutua edhe organizimi i një vizite studimore në Agjencinë e Investimeve të Huaja dhe Promovimit të Eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për të shkëmbyer përvojat dhe eksperiencat në tërheqjen e investimeve të huaja dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve vendase për dy vendet, por edhe në të mirën e rritjes ekonomike në rajon. Zhvillimi i këtij takimi vjen në kuadër të forcimit të marrëdhënieve të mira institucionale dhe rritjes së bashkëpunimit në projekte me ndikim në zhvillimin e Ballkanit Perëndimor.



Takim midis AIDA-s dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Në muajin janar 2020, në zyrat e AIDA-s u zhvillua takimi mes përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe përfaqësuesve të AIDA-s, për të shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit mes institucioneve. Gjatë takimit u diskutua mbi mundësitë për të qënë më pranë biznesit dhe për t'i ofruar mbështetjen e nevojshme, jo vetëm në kuadër të fondeve që akordohen për fuqizimin e tyre.

Mundësitë konkrete të bashkëpunimit mes AIDA-s dhe DPPI, do të shtrihen në aktivitetet "Info day", ku institucionet janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me kompanitë dhe mund të njihen më nga afër me nevojat e tyre.

Në takim u dakordësua mbi mundësinë e nënshkrimit të një memorandumi bashkëpunimi çka do të formalizojë më tej modalitetet e përbashkëta të ndërveprimit mes AIDA-s dhe DPPI.



Enterprise Europe Network (EEN)



Rrjeti European i Ndërmarrjeve (Enterprise Europe Network) është rrjeti më i madh në botë, i cili mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME's/NVM) me synim inovacionin dhe rritjen e tyre në shkallë ndërkombëtare. Ky rrjet bashkëfinancohet nën programin COSME (Konkurueshmëria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme), një program i financuar nga Bashkimi Europian, i krijuar për të inkurajuar konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve europiane.

Rrjeti është aktiv në më shumë se 60 vende të botës. AIDA, është partneri kryesor udhëheqës i Konsorciumit Shqiptar të Enterprise Europe Network, i cili përbëhet në total nga 4 partnerë: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCIT), Insituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen (IPPM) dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL).

AIDA, si lider i konsorciumit shqiptar të Rrjetit European të Ndërmarrjeve (EEN Albania), priti në një takim përfaqësuesit e Prishtina REA

Në kuadër të projektit të EEN, AIDA priti në takim përfaqësues të Prishtina REA, agjenci kosovare e angazhuar në zhvillimin ekonomik, sektorin privat, rininë e punësimin, bashkëpunimet ndërkombëtare dhe njëkohësisht pjesë e programit COSME EEN-Kosova.

Në takim u diskutua mbi ecurinë e programit në Shqipëri, praktikave implementuese, rrjetëzimin dhe shkëmbimin e eksperiencës mes SME-ve, si dhe mundësitë për partneritete e bashkëpunime ndërkombëtare. Takimi do të jetë një mundësi e mirë për fillimin e një bashkëpunimi mbi mundësitë konkrete lidhur me identifikimin e pikave të përbashkëta, në kuadër të misioneve të ngjashme të institucioneve dhe roleve përkatëse në Rrjetin European të Ndërmarrjeve.



AIDA, në bashkëpunim me Risi Albania, përgatitën edhe broshurën “Enjoy Bio Albania”, e cila përmban informacion mbi zhvillimin e sektorit të bimëve medicinale dhe aromatike në Shqipëri, si edhe informacion të përgjithshëm për 5-kompanitë pjesëmarrëse në panair..

Broshura është e botuar në gjuhën angleze, të cilën mund ta gjeni në faqen e AIDA-s: www.aida.gov.al, ose duke klikuar linkun në vijim: <http://aida.gov.al/sektori-i-bimeve-aromatike-dhe-medicinale-ne-shqiperi/>



Shtetet e Ballkanit Perëndimor bashkohen në Sofje për të diskutuar mbi zhvillimin e start-up dhe inovacionit në sipërmarrjet e vogla dhe të mesme

Në muajin janar 2020 u zhvillua në Sofje, Bullgari, takimi mes Krerëve të Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e inovacionit dhe start up-ve. Kryefjala e këtij takimi ishte bashkëpunimi midis vendeve të Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, me fokus inovacionin dhe start up-et.

Gjatë takimit, Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, ndau me të pranishmit projektet dhe fondet që Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ofron në mbështetje të sipërmarrjeve të reja inovative. Ky takim kishte qëllim për koordinimin e punëve të shteteve të Ballkanit Perëndimor në një destinacion tërheqës për teknologjinë dhe inovacionin.

Ky takim për zhvillimin e inovacionit dhe start up-ve, u pa si një mundësi për shkëmbimin e eksperiencave, si dhe zhvillimin e lidhjeve për zgjerimin e kontakteve të drejtpërdrejta midis kompanive inovative në rajonin e Ballkanit Perëndimor.





NEWSLETTER

Janar - Mars 2020

FLUKSI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE (IHD), NË VITIN 2019 ARRITI NË VLERËN E 1.08 MILIARDË EURO DHE ËSHTË RRIUR ME 59 MILION EURO (OSE 5,7%) NË KRAHASIM ME VITIN PARAARDHËS.

Shifra rekord prej 1.08 miliardë euro Investime të Huaja Direkte përfshin investimet në sektorin e energjisë, i cili është sektori që tërhoqi më shumë investime në 2019-n me 31% të totalit, pasuar nga industria nxjerrëse me 20% të totalit.

Stoku i IHD-ve në Shqipëri ka patur një trend rritës përgjatë periudhës 2014-2019 duke shënuar vlerën më të lartë në vitin 2019.

Për sa i përket shpërndarjes së fluksit të investimeve në aktivitete të tjera, industria nxjerrëse, ndërtimi, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, artet, argëtimi dhe çlodhja rezultojnë sektorë dominues në rritjen e kapitalit të investimeve për vitin 2019.

Shtetet që kanë investuar shifrat më të larta në Shqipëri janë Holanda dhe Zvicra përkatesisht në vendin e parë dhe të dytë, ndërsa në vendin e tretë renditet Italia me 120 milionë euro, një dyfishim i vlerës së investuar nga viti i kaluar.

BURIMI: BANKA E SHQIPËRISË

AIDA
Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Shtetit për Investimet

invest in Albania

1.08 MLD EURO

INVESTIME TE HUAJA NË VITIN 2019

5.7%

RRITJE
NË KRAHASIM ME
VITIN E KALUAR





TAKIME SHUMËPALËSHE

AIDA në Asamblenë e Përgjithshme “Investimet e huaja në Shqipëri dhe Prezantimi i Guidës së Biznesit 2020”

Në muajin janar 2020, u zhvillua Asambleja e Përgjithshme me temë “Investimet e huaja në Shqipëri, Prezantimi i Guidës së Biznesit 2020”, e organizuar nga Konindustria Albania – Shoqata e Industrialistëve italianë në Shqipëri. Në aktivitet u prezantua Guida e Biznesit 2020, ku tregohet se mundësitë për të zhvilluar biznes në Shqipëri janë të mëdha, ashtu sikurse edhe potenciali ekonomik i vendit tonë.

E pranishme në aktivitet ishte dhe përgjegjësjja e sektorit afërcare, pranë AIDA-s, Znj. Dorina Patuzi, e cila bëri një prezantim të AIDA-s dhe ndihmës që agjencia ofron për investitorët e huaj. AIDA është një dritare unike, e cila u siguron investitorëve ndihmë profesionale përgjatë gjithë fazës së implementimit të planit të biznesit. Kjo u theksua edhe nga Ministrija e Financave dhe Ekonomisë Z. Anila Denaj, e cila vlerësoi punën e bërë nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për investitorët e huaj.



AIDA, pjesë e delegacionit shqiptar në vizitën zyrtare të zhvilluar në Kroaci

Në kuadër të vizitës zyrtare të zhvilluar nga Ministrija e Financave dhe Ekonomisë Znj. Anila Denaj, në Kroaci në muajin janar 2020, u mbajt edhe Forumi i Biznesit “Kroaci - Shqipëri”, me pjesëmarrjen e dy ministrave respektivë, si dhe përfaqësuesve të sipërmarrjeve kroate dhe shqiptare. Në forum ishte pjesëmarrës dhe Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit pranë AIDA-s, Z. Genc Çeli, i cili prezantoi të dhëna për mundësitë e të bërit biznes në Shqipëri, mundësitë për investime dhe partneritete, si dhe rolin e AIDA-s në asistencën ndaj investitorëve të huaj dhe atyre shqiptarë. Gjatë forumit u nënshkrua edhe një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Dhomës Kroate të Ekonomisë dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, për t'i hapur rrugë bashkëpunimit dhe forcimit të marrëdhënieve institucionale dypalëshe.

Mbahet për herë të parë “Samiti i Grave të Biznesit” në Tiranë

Në janar 2020, hapi siparin “Samiti i Grave të Biznesit”. Në këtë samit ishin të pranishëm Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Znj.Anila Denaj, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Z.Eduard Shalsi dhe Ministri i Shtetit për Diasporën, Z. Pandeli Majko.

Znj.Dorina Patuzi, përgjegjëse e sektorit të kujdesit ndaj biznesit përveç prezantimit të aktivitetit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bëri me dije se në kuadër të fondeve që AIDA menaxhon, Fondi i Artizanatit i dedikohet kryesisht grave sipërmarrëse, duke krijuar dhe hapësirat për pjesëmarrje në panire jashtë vendit. Në samit u nënvizua edhe bashkëpunimi me Dhomën e Biznesit të Diasporës, i cili do të jetë frytdhënës në konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe.



Vizitë në “ONUS Maison” ku takohet krijimi, teknologjia dhe inovacioni

Në kuadër të fushatës për këshillim, lehtësim dhe mbështetje të veprimtarisë së investitorëve, drejtori ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano vizitoi kompaninë ONUS Maison, një emër 90-vjeçar në historinë e modës shqiptare. ONUS Maison operon në sektorin e tekstileve, me një histori suksesi që prej vitit 1927. Atelieja përqëndrohet kryesisht në veshje për femra, por edhe aksesore si kollaret e famshme 3D me modelime unike.

AIDA, i jep një rëndësi të veçantë identifikimit të nevojave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe veçanërisht kompanive operuese në sektorin e tekstileve. AIDA, me programin e përkujdesjes ndaj investitorëve synon t’i mbështesë duke i asistuar në identifikimin e problematikave dhe adresimin e tyre në zgjidhjen përfundimtare.





BOTIME

“Albania Calls - A Country of Opportunities”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ju fton të shfletoni broshurën “Albania Calls - A Country of Opportunities” duke klikuar linkun më poshtë:

<http://aida.gov.al/albania-calls-a-country-of-opportunities/>

Në këtë botim të ri të broshurës, do të gjeni arsyet kryesore për të investuar në Shqipëri bashkë me të dhëna mbi klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Cjithashtu pjesë e broshurës janë incentivat mbi sektorët kryesorë të investimit në Shqipëri si: energjia, turizmi, bujqësia, manufaktura, zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik (TEDA) etj., të shoqëruara me pamje të pikave turistike në Shqipëri.



**READY TO TALK
GROWTH?**



SHFLETO BROSHURAT E REJA TË AIDA-S

“Bring Your Business to Albania “

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ju fton të shfletoni një nga broshurat më të reja online “Bring Your Business To Albania”, duke klikuar linkun në vijim:

<http://aida.gov.al/bring-your-business-to-albania/>


Në këtë broshurë do të gjeni arsyet kryesore pse duhet të investoni në Shqipëri dhe informacionet më të rëndësishme për sektorët potencialë.

“

Albania's economic growth remains strong.

The country has benefited from implementing new reforms.

IMF (International Monetary Fund)



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve organizon një aktivitet në qytetin e Korçës për ndërtimin e kapaciteteve të institucionit

Stafi i AIDA-s organizoi për herë të parë një takim jashtë ambienteve të zyrës, me qëllim kryesor zhvillimin e kapacitetit të burimeve njerëzore të institucionit.

Një fokus shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës në vitin 2020 është vendosja e objektivave për tu përmbushur nga secila drejtori e AIDA-s si dhe matja e tyre në mënyrë sa më efektive. Për këtë arsye, gjatë takimit u prezantuan pritshmëritë mbi arritjet për vitin 2020 si dhe plani i punës i detajuar me objektiva të cilat do të shërbejnë për të përmbushur këto pritshmëri.

Në këtë aktivitet një ditë të zhvilluar në qytetin e Korçës, në muajin janar, morën pjesë punonjësit e të gjitha drejtorive të institucionit nën drejtimin e Drejtorit Ekzekutiv Z. Sokol Nano.





NJOFTIM

Mbi disa ndryshime në Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ju informon mbi Ligjin Nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt” të ndryshuar”.

Ndryshimet dhe shtesat shtrihen në tri fusha kryesore që rregullohen nga Ligji Nr.108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar. Fushat të cilat kanë pësuar ndryshime janë: politika e vizave; politika e qëndrimit dhe politika e punësimit të të huajve.

1. Politika e vizave me qëllim krijimin e mekanizmave të nevojshëm për lëshimin e vizave elektronike.
2. Politika e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë me qëllim shkurtimin e afateve për shqyrtimin dhe lëshimin e lejes së qëndrimit.
3. Politika e punësimit të të huajve me qëllim përmirësimin e disa dispozitave të lidhura me lejen e punës dhe punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, duke qartësuar afatet kohore dhe procedurat për t’u pajisur me leje pune dhe duke reduktuar pengesat e panevojshme për punësimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Këto ndryshime do të kenë efekt direkt në rritjen e numrit të shtetasve të huaj që dëshirojnë të vizitojnë Shqipërinë, të bëjnë biznes në shqipëri, apo që e shohin Shqipërinë si një mundësi për punësim.

Për t’u njohur me ndryshimet më konkretisht në secilën nga fushat e mësipërme, të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 25 mars 2020, vizitoni linkun:

http://aida.gov.al/wp-content/uploads/pdf/ligji%20per%20investitoret%20e%20huaj.pdf?fbclid=IwAR10i5AsOIF6sc0D-kNsYYTxFmuelp_1HVyfAiNvzzjHSHG6LcaR2nLcf_Vo



Në AIDA, ekipi ynë i specializuar, multidisiplinar do t’ju ofrojë shërbime profesionale pa kosto, të përshtatura me nevojat e projektit tuaj.

Adresa: Bulevardi. “Dëshmorët e Kombit”, Kryeministria, Kati III, Tiranë

E-mail: info@aida.gov.al Web: aida.gov.al Tel: +355 (0)42 251 001



invest in Albania

